



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2019:267396
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05602220

K.Dh.Sh.II.nr.1005/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Franciska Zhitija - Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSH “Jetta” me seli në Podujevë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1670/17 të datës 15.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal A.nr.1670/17, i datës 13.11.2020, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal A.nr.1670/17, të datës 13.11.2020, në pikën I të dispozitivit aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTSH “Jetta” me seli në Podujevë, në pikën II të dispozitivit anulohet aktvendimi i të paditurës Doganës së Kosovës në Prishtinë nr.408/2014 i datës 19.04.2015, dhe në pikën III të dispozitivit Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës LKA , me propozimin që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar në ligj, të prishet aktgjykimi A.nr.1670/17 i datës 13.11.2020 si i pa bazuar në ligj, të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pabazuar në ligj dhe të mbetet në fuqi vendimi i kontestuar ose t’ia kthej gjykatës në rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim

të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.07.3/408/2014 të datës 25.08.2017, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë Agjensioni Doganor “Jetta” – Podujevë për rishqyrtimin e vendimit 07.3/408/2014.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës. Në arsyetimin e aktgjykimit kontestues është theksuar se Gjykata nuk mund ta pranoj si të drejtë vlerësimin faktik dhe juridik të Doganës së Kosovës lidhur me dhënien e të drejtës vetit që të marr një vendim të tillë për revokimin e certifikatës së licencimit të paditësit, duke u thirrur në humbje besimi, para se të përfundoj rasti i iniciuar dhe të konfirmohet nga gjykata se personat përgjegjës të këtu paditësit kanë kryer vepër penale. Tutje për ta forcuar këtë edhe vet zyra doganore Podujevë në pjesën e fundit të vendimit thekson se pas përfundimit të hetimeve do të merret një aktvendim tjetër përfundimtar, e kjo për gjykatën vetëm se e forcon bindjen se zyra doganore Podujevë nuk ka respektuar kushtet ligjore nga vet dispozita e nenit 11.4 të KDA-së, për të pritur rezultatin nga gjykata e lidhur me iniciimin e rastit penal, por paraprakisht sjell një vendim për revokim licence, e që me këtë edhe bën shkelje të ligjit në dëm të këtu paditësit andaj edhe doemos u desh që ky aktvendim të anulohet.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave

të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe provat lidhur me këtë çështje, pasi që pjesa e aktgjykimit ku flet për vlerësimet faktike dhe juridike gjykata e shkallës së parë konsideron se humbja e besimit nga ana e doganës është bërë në mënyrë të njëanshme. Në këtë rast gjykata nuk merr për bazë apo nuk përmend asnjë nga provat e lëndës që kanë të bëjnë me deklaratat e dëshmitarëve që kishin qenë prezent në këtë rast, e po ashtu edhe nga deklaratat e paditësit nga të cilat fare qartë mund të vërehet se në atë rast ka ndodhur një situatë mosmarrëveshje, apo sjellje joprofesionale e paditësit, fakt të cilin e ka potencuar edhe gjykata në paragrafin e fundit të faqes së dytë të aktgjykimit A.nr.1183/14/16.11.2016. Këtë përetendim të paditurës kolegji i kësaj gjykate e konsideron si të pabazuar për faktin se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka sqaruar se nga intepretimi i dispozitës ligjore të nenit 11, par. 4, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, gjykata konstaton se e paditura ka pasur të drejt ta revokoj licencën e paditësit vetëm atëherë kur personi i licencuar të shpallet fajtor për kryerje të veprës penale për të cilën është akuzuar, dhe jo të marr vendim për revokim të licencës duke bërë paragjykim të veprimeve hetimore. Nga provat që i ka ofruar pala paditëse, gjykata konstaton se Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktvendimin PP.II nr.2242/2014 dt.25.09.2014 ka hedhur poshtë kallëzimin penal të stacionit policor në Podujevë, të ushtruar kundër të dyshuarit F.M., nga P. Në bazë të këtij aktvendimi të Prokurorisë kompetente, kjo gjykatë nuk ka arrit të vërtetoj se paditësi është shpall fajtor për kryerje të veprave penale që përfshihen me dispozitën e nenit 11 par. 4, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Numri i lëndës: 2019:267396
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05602220

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1005/22, me datë 22.04.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova